



REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I ARTEVE
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE
SEKRETARI

Nr. 500/prot.
12

Tiranë, më 12/04/2024

Lënda: Përcillet Vendimi nr. 2, datë 12.04.2024 “Për hapjen e procesit të aplikimeve për anëtarë të KZF-ve në Fakultetet e Universitetit të Arteve”

DEKANIT TË FAKULTETIT TË MUZIKËS
Prof. Dr. Isak SHEHU

DEKANIT TË FAKULTETIT TË ARTEVE TË BUKURA
Prof. Artan PEQINI

DEKANIT TË FAKULTETIT TË ARTIT SKENIK
Prof. Ilir MARTINI

Të nderuar,

Bashkëngjitur përcillet për njohje dhe zbatim Vendimi nr. 2, datë 12.04.2024 “Për hapjen e procesit të aplikimeve për anëtarë të KZF-ve në Fakultetet e Universitetit të Arteve”.

Deri në mundësimin nga Administratori i UART të një ambienti që do të shërbejë si zyrë për KIZ, njoftojmë se sekretaria e KIZ do të funksionojë pranë Sekretarisë së Fakultetit të Artit Skenik.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin,

SEKRETARI

Redjan MULLA



Nr. 500/1 prot.

Tiranë, më 12.04.2024

VENDIM

Nr. 2, Datë 12/04/2024

**“PËR HAPJEN E PROCESIT TË APLIKIMEVE PËR ANËTARË TË KZF-VE NË
FAKULTETET E UNIVERSITETIT TË ARTEVE”**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Urdhrit nr. 101, datë 13.03.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Arteve”, miratuar me VSA nr. 17, datë 29.03.2024; sot më datë 12.04.2024, u mblodhën:

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të KZF-ve të fakulteteve të cilët vetëkandidohen duke dorëzuar aplikimin në sekretarinë e KIZ.
2. Procesi i pranimit të aplikimeve bëhet **pranë sekretarisë së KIZ në datat 15, 16 dhe 17 Prill 2024, nga ora 10.00 – 12.00.**
3. Ky vendim i përcillet Drejtuesve të Njësive Kryesore.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Orges Malaj

Kryetar

Shpëtim Kërçova

Anëtar

Suela Agolli

Anëtar

Adela Kusuri

Anëtar

Sara Caca

Anëtar

Redjan Mulla

Sekretar